

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“INOVA WOOD 23”

KREU I

Shoqeria eshte e themeluar dhe rregjistruar prane QKR-se tashme,por ne zbatim te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret e shoqerite tregtare” dhe te Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” , ortaku I vetem i shoqerise eshte Z. Xhevahir Mustafa vendosi qe te hartoje kete statut te ri.

Shoqeria eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj:

1. Xhevahir Mustafa, i biri i Hamitit, i datelindjes 05/07/1981, lindur ne Fushe Arrez dhe banues ne Tirane, Rruga “ Sheh Ahmet Pazar, Nd2, H1, Ap 1, me leter njoftim I10705220G .

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie (Akt themelimin dhe Statutin) dhe legjislacionin shqiptar. Ajo rregullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri ,te dhenat me rendesi ne qarkullimin juridik,organizimin,objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.
Shoqeria ka vulen e sa,shkruar Shoqeria “ ”
Shoqeria kryen veprimtarine e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit,sigurise dhe rentabilitetit.

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet “ **Inova Wood 23” sh.p.k.**

NENI 2

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: “Autostrada Tirane-Durres, Km i 8-te, prane City Park, Z.Kadestrale 1167, Bexull, Tirane”

NENI 3

Shoqeria eshte themeluar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhen kohe te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

Prishja dhe likujdimi I Shoqerise do te kryhet me vendim te Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacioni ne fuqi

NENI 4

Shoqeria **“Inova Wood 23” sh.p.k.**, ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Import eksport te produkteve te gateshme prej druri, perpunim te lendes drusore per prodhimin e mobiljeve, karrikeve e orendive gjysem produkte, elemente e detale druri te ndryshem.
- Prodhim e perpunim te artikujve te drurit, industrial e ushqimor, tregetimin e tyre me shumice e pakice.
- Tregetimin e mallrave drusor, industriale e ushqimore si lende te para, veprimtari ne fushen e industris mekanike qe lidhen me prodhimin, mirembajtjen dhe shitjen e teknologjive duke hapur pika sherbimi per riparimin e tyre.
- Transport per vehte dhe per te trete
- si dhe çdo aktivitet tjeter qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi

Objekti i veprimtarise se Shoqerise mund te ndryshohet/shtohet me vendim te ortakut te vetem, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

KAPITALI I SHOQERISE**NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000,00** (njqind mije) Leke.

Numri i kuotave eshte 1,00 (nje) me vlere nominale te barabarte me 100.000,00. (njqind mije)leke

Kuota eshte e transferueshme ne cdo kohe, ne perputhje me kushtet e legjislacionit ne fuqi

Pergjegjesia e Ortakut te Vetem eshte e kufizuar deri ne vleren e shlyer te kontributit te tij ne kapitalin themeltar

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribut ne sherbime.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve. Kuotat e pjesemarresve ne kapital, jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme.

Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij, jane te transferueshme perkundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit ne favor te nje personi te trete behet me akt noterial.

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht, duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejte ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mosushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet nga mjetet e xhiros, pasuri te luajteshme ose te paluajteshme qe mund te shtohen gjate periudhes ushtrimore etj., te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Kuotat e kapitalit themeltar jane te siguruara nga ortaket themelues te shoqerise dhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 9

Shoqeria tregtare **“Inova Wood 23” sh.p.k.**, eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republikën e Shqiperise, shoqeria tregtare **“Inova Wood 23” sh.p.k.**, gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria tregetare **“Inova Wood 23” sh.p.k.**, vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Shoqeria pergjigjet me fondet e veta.

Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaku ka patur para se ajo te krijohet.

NENI 11

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e cliron ortakun e larguar nga detyrimet qe i kane lindur atij para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton edhe te drejtat qe i jane krijuar para largimit te tij.

NENI 12

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve ne proporcion me perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Rritja e kapitalit nga ortakët do te behet vetem me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**NENI 13**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e ortakeve.
2. Administratoret.
3. Komisioni i revizionimit kontabel.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE**NENI 14**

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.

Ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote sipas madhesis se shumave te vena per krijimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja e ortakeve vendos per:

- i. percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
- ii. ndryshimin e Statutit te Shoqerise;
- iii. emerimin dhe shkarkimin e administratorit/reve;
- iv. emerimin dhe shkarkimin e likujduesit/v edhe auditusit/ve ligjore;
- v. rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltare;
- vi. miratimin e pasqyrave finaciare, raporteve mbi ecurine e veprimtarise dhe shperndarjen e fitimeve vjetore;
- vii. miratimin e shperblimeve per administratorin/ret , likuiduesin dhe audituesin ligjore;
- viii. riorgabizmin, prishjne, transformimin, bashkimin me perthitje, ndarjne ose likuidimin e shoqerise ose shnderrimin e forms ligjore te saj;
- ix. pjesemarrja ne kapitalin themeltare te cdo shoqerie tjetere e cila ka objekt te ngjashem veprimtarie;
- x. ceshtje te tjera sic parashkohet nga legjislacioni i zbatueshem dhe/ose ky Statut

NENI 15

Mbledhjet e Asamblese jane te vlefshme kur ortaket qe marrin pjese ne te, posedojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar, dhe vendimet merren me shumice votash, me perjashtim te rasteve te meposhtme, kur kerkohet qe miratimi te behet me me shume se 75 % te pjeseve te kapitalit themeltar:

- Modifikimi i Statutit.
- Ndryshimi i kapitalit themeltar.
- Destinimi i fitimit neto te realizuar.
- Miratimi i programit vjetor te shoqerise.
- Zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise.
- Shkrirja e shoqerise.

NENI 16

Asambleja e ortakeve thirret sa here qe e shohin te arsyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardhshem, dhe deri ne qershor per te miratuar bilancin kontabel per vitin e meparshem.

Asambleja mbliidhet kur kerkohet nga administratoret, komisioni i revizionimit kontabel, ose nga ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 20% te pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 17

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjeter. Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

NENI 18

Asamblene e kryeson nje nga ortaket e zgjedhur, ose ne mungese te tij, administratori ose nje avokat i caktuar.

Vendimet e Asamblese jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga te gjithet ortaket, qofte edhe per ata qe nuk kane marre pjese ne mbledhje.

ADMINISTRATORET

NENI 19

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratoret e saj ose nga persona te tjere te autorizuar prej tyre. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Administratoret jane perfaqesuesit legale te shoqerise, ndaj autoriteteve administrative financiare dhe juridike, te cdo lloji dhe shkalle. Administratore te shoqerise caktohet Z. Xhevahir Mustafa. Administratori i shoqerise e ushtron detyren e tij me afat 5 vjet dhe jane te rizgjedhshem duke filluar nga data e regjistrimit te tyre ne QKR.

NENI 20

Administratori i shoqerise u perket pushteti administrativ. Ai ka te gjitha kompetencat qe te veprojne ne emer te shoqerise dhe per llogari te saj, ne marredhenie me personat e trete.

NENI 21

Administratori/et jo-ortake, pervec detyrave qe u caktohen nga ortaket e shoqerise, kane edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mireadministrojne pasurine e shoqerise.
2. Te bejne marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket themelues.

3. Te zbatojne rregulloren e brendshme te shoqerise.
4. Te pergjigjen per demet qe i sjellin shoqerise, me veprimet e tyre.
5. Te paguhen per punen qe kryejne, ne baze te marreveshjes se bere me ortaket themelues.
6. Te marrin te dhena dhe te bejne propozime per gjithcka qe e cmojne si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryejne te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

NENI 22

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Asnje vendim i Asamblese nuk mund te ndaloje kerkese-padine ndaj administratoreve, per gabimet e kryera prej tyre gjate ushtrimit te detyres.

KOMISIONI I REVIZIONIMIT KONTABEL

NENI 23

Kryetari dhe anetaret e ketij Komisioni emerohen nga Asambleja e ortakeve, duke u zgjedhur ndermjet bashkepunetoreve te ortakeve.

Anetaret e Komisionit te Revizionimit, zgjidhen per nje periudhe 3 vjecare. Komisioni i revizionimit ka te drejte te kontrolloje aktivitetin e shoqerise ne te gjitha aspektet e saj, te ushtroje kontrole kontabel, te kontrolloje bilancin ne perputhje me Statutin dhe ligjet ne fuqi.

Komisioni i revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se ortakeve, dhe eshte i detyruar t'i paraqese asaj cdo vit raporte per kontrollet e bera, si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 24

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka, ne perputhje me objektin e veprimtarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te cele llogari prane bankave vendase e te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit te tyre.

4. Te marre kredi ne Leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja, ne baze te rregullave ligjore.
5. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar, lidhur me tatimet, etj.
6. Te investoje kudo ne Shqiperi dhe jashte saj nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
7. Te punesoje punojnes te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
8. Te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e fitimit ne valute.

NENI 25

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe ajo kryen.
3. Te siguroje punonjesit e saj konform akteve ligjore per sigurimet shoqerore e shendetesore, dhe atyre te percaktuara ne Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si dhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 26

E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 27

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te cdo viti, nxirret bilanci.

NENI 28

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor

NENI 29

Shoqeria mban llogarite ne banke. Llogarite mbahen ne Leke dhe ne valute dhe pasqyrohen ne librat perkates.

NENI 30

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije ne masen 10% te kapitalit themeltar.

NENI 31

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbeten ne perdorim ortakeve themelues te shoqerise. Fitimi i realizuar nga shoqeria mund te perdoret per investime, per shtimin e kapitalit te shoqerise, ose mund te ndahet ndermjet ortakeve te saj ne perputhje me perqindjen e kapitalit te investuar.

Konvertimi i parase se realizuar nga shitja, do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit Shqiptar, ose bankat e tjera private, dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VECANTA**NENI 32**

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**NENI 33**

Shnderrimi i shoqerise "**INOVA WOOD 23**" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive apo me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 34

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si:

1. Humbja e kapitalit te shoqerise
2. Pamundesi veprimi
3. Me vendim te Asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar e dhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise, perderisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit si dhe personave te trete qe ka shoqeria.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 35

Mosmarveshjet ndermjet ortakeve, si dhe ato te shoqerise ne marredhenie me personat juridike e fizike, vendas apo te huaj, zgjidhen me mirekuptim. Ne te kundert, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane.

NENI 36

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, t'i referohet plotesimeve qe do te behen nga ortaket themelues, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij Statuti, behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete Statuti.

NENI 37

Ketij Statuti mund t'i behen amendamente sa here qe asambleja e sheh te arsyeshme. Per amendamentet asambleja duhet te vendose sipas percaktimeve qe ben ligji.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

'INOVA WOOD 23" sh.p.k.

Tirane, me 23/01/2023